



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426

KONTRATË SHITJE PASURIE LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 5884

Nr. koleksioni: 3646

Tirane më 11/10/2022

Ujgret referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterine", i ndryshuar

Akti është pajtimor dhe i ligjshëm.



A2022053150392850812

11

KONTRATE SHITJE
ME KUSHT
E KUOTAVE TE SHOQËRISE



Në Tiranë, sot në datën 11 / 10 / 2022 (dymijë e njëzetë e dy), përpara meje, noterit Ermal Xh. Hamzaj, Anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me licencë profesionale nr.511, në zyrën time noteriale me adresë Rr. "Pashko Vasa", u paraqitën personalisht palët:

Shitësi:

1 - Shoqëria "2RC" Sh.p.k. (ish 2R-Construction sh.p.k.), shoqëri tregtare e regjistruar pranë QKB më datë 03.11.2008, e identifikuar me NUIS: K82303007K, me seli në: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Pashko Vasa", Pallati Nr. 8, Tiranë; përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm, Z. Bardhyl Hysenbelliu, atësia Hasan, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 27.05.1967, lindur në Potom dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin ID me Nr. 033761089 dhe nr. Personal G70527056Q,

Dhe

2- Shoqëria "JDS" Sh.p.k., shoqëri tregtare e regjistruar pranë QKB më datë 12.03.2013, e identifikuar me NUIS: L38912401L, përfaqësuar nga administrator, Z. Misir Dymishi, atësia Jaçe, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 27.10.1964, lindur në Çorovodë, identifikuar me letërnjoftimin ID me Nr. 033347738 dhe nr. Personal G41027042H,

të dy këtu e më poshtë referuar në këtë kontratë si **Shitësi**;

Dhe

Blerësi

Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k., shoqëri tregtare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mbajtëse e NUIS L91924026B, me seli në Fier, Lagjja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier - Tiranë, pranë Urës së Mbrostarit, e përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë **Z. Zeni Tërpollari**, lindur më datë 13.08.1984 në Çorovodë, Skrapar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 035364689 dhe numër personal I40813012F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, Nr. 28 datë 10.10.2022, bashkëlidhur kësaj kontrate,

këtu e më poshtë referuar në këtë kontratë si **Blerësi**;

Dhe

Miratuesi

Shoqëria "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., shoqëri tregtare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, më 04.10.2013, me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L39604402S, me adresë: Berat, Çorovodë, Komuna Qëndër, Buzuq, përfaqësuar nga Administratori, Z. Joni Dymishi, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, atësia Misir, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë,

(Handwritten signatures in blue ink)



Skrapar, më 26.05.1994 dhe banues në Skrapar, me adresë: E Kanioneve, Nd. 17; H.1; Corovodë; 5401, Skrapar; për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036386211 dhe nr. personal J40526003V,

sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, Nr. 2 datë 10.10.2022, bashkëlidhur kësaj kontrate,

këtu e më poshtë referuar në këtë kontratë si **Miratuesi**.

Hyrje

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake:

- A- Shoqëria "2RC" Sh.p.k. dhe Shoqëria "JDS" Sh.p.k. janë ortakë të shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" sh.p.k., shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB më datë 04.10.2013, me NIPT/NUIS L39604402S dhe zotërojnë konkretisht: **Shoqëria "2RC" sh.p.k.** zotëron 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë, numri i pjesëve të kapitalit 5 (pesë), me vlerë totale 5 lekë dhe **Shoqëria "JDS" sh.p.k.** zotëron 95% (nëntëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë, numri i pjesëve të kapitalit 95 (nëntëdhjetë e pesë), me vlerë totale kapitali 95 Lekë.
- B- Shoqëria "HP VENDRESH ENERGY" sh.p.k. është themeluar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "JDS" sh.p.k., dhe "2R-Construction" sh.p.k., sipas Marrëveshjes nr. 1296 Rep., nr. 235 Kol., datë 25.03.2013.
- C- Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "JDS" sh.p.k. dhe "2R-Construction" sh.p.k., sipas Marrëveshjes nr. 1296 Rep., nr. 235 Kol., datë 25.03.2013, në cilësinë e Koncesionarit, ka lidhur me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (në cilësinë e Autoritetit Kontraktues) Kontratën e Formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit "VENDRESH" në pellgun Ujëmbledhës përroi Vendreshës, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar, Nr. 10325 Rep., nr. 3319 Kol., datë 06.09.2013 – noter Julian Zhelegu, Tiranë, bashkëlidhur kësaj kontrate; të ndryshuar me Kontratë Shtesë Koncesioni për Disa Ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT", për ndërtimin e Hidrocentralit "Vendresh", nr. 663 Rep., nr. 228 Kol., datë 18.05.2016 – notere Elona G. Qoku.
- D- **Shoqëria "2RC" sh.p.k. dhe Shoqëria "JDS" sh.p.k.** dëshirojnë të shesin individualisht të gjitha kontributet e tyre që zotërojnë në Shoqërinë "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., (që përfaqësojnë në total 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë), Shoqërisë "AG Hpower & Construction" Sh.p.k., sipas kushteve të mëposhtme.

Palët me vullnet të lirë dhe të plotë hartuan këtë kontratë shitje kuatash me kusht si më poshtë:

NENI 1

Qëllimi i kontratës

- 1.1 Qëllimi i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i pronësisë së 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., të zotëruara nga shitësi "2RC" Sh.p.k., në masën 5% (pesë përqind) dhe "JDS" Sh.p.k., në masën 95% (nëntëdhjetë e pesë përqind), tek Blerësi, Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.
- 1.2 Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë, si dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim.

10/10/10

- 1.3 Në përcaktim të kushteve, palët konsiderojnë të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin përsipër të ekzekutojnë veprimet e tyre brenda kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

NENI 2 Objekti i Kontratës

- 2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësit transferojnë secili individualisht në favor të blerësit kontributet/kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në shoqërinë **“HP VENDRESH ENERGY” Sh.p.k.**, (të cilat përfaqësojnë në total 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë) në bazë të çmimit të përcaktuar në nenin 3 më poshtë dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8 si më poshtë.
- 2.2 Gjithashtu, blerësi do të blejë nga shitësit të gjitha kontributet e zotëruara prej tyre në Shoqëri, të cilat përfaqësojnë në total 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, në bazë të çmimit të përcaktuar në nenin 3 më poshtë, dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8 si më poshtë.

NENI 3 Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 3.1 Të dyja palët kanë rënë dakord midis tyre që çmimi i shitjes së të gjithë kontributeve të zotëruara nga shitësit do të jetë **EUR 150 000** (njëqind e pesëdhjetë mijë euro), i ndarë konkretisht:
- a) Shoqëria **“2RC” Sh.p.k.** do t'i shesë kuotat që zotëron prej 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë **“HP VENDRESH ENERGY” Sh.p.k.**, në shumën prej EUR 7500 (shtatë mijë e pesëqind euro);
 - b) Shoqëria **“JDS” Sh.p.k.** do t'i shesë kuotat që zotëron prej 95% (nëntëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë **“HP VENDRESH ENERGY” Sh.p.k.**, në shumën prej EUR 142 500 (njëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind euro).
- 3.2 Çmimi i shitjes në total në vlerën **EUR 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro)** do të depozitohet nga blerësi në llogaritë bankare të shitësve përkatësisht sa më sipër, brenda një afati prej **10 (dhjetë)** ditësh, duke filluar nga data e aprovimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për Shit-Blerjen nëpërmjet transferimit të Kuotave të kapitalit.
- 3.3 Shumat e përcaktuara më sipër, në vlerat përkatëse të palëve shitëse, do të transferohen nga blerësi tek llogaritë bankare të shitësve nëpërmjet llogarive bankare të mëposhtme:
- **Shoqëria: 2RC SHPK**
Nr. llogarie: 402 345 070
Swift: NCBAALTX
IBAN: AL17 2051 1021 3450 70CL PRCF EURA
Banka: Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
 - **Shoqëria: JDS SHPK**
Nr. Llogarie: 516 008 165
Swift: NCBAALTX
IBAN: AL30 2051 1667 0081 65CL PRCF EURT
Banka: Banka Kombëtare Tregtare (BKT)




11/11/11

1

NENI 4
Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

- 4.1 Shitësit, nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash, garantojnë si më poshtë:
- a. Shitësit janë të vetmit titullarë të ligjshëm të kuotave që po transferohen me këtë kontratë shitje;
 - b. Kuotat objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër;
 - c. Transferimi i këtyre kontributeve të shitësve në drejtim të blerësit është bërë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutores;
 - d. Shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;
 - e. Shitësit detyrohen, që me nënshkrimin e kësaj kontrate, të mos shesin/ dhurojnë/heqin dorë apo tjetërsojnë, në çdo lloj forme juridike pa kufizim, kuotat e tyre në favor të palëve të treta, në të kundërt, çdo akt i kryer prej tij është pa fuqi ligjore;
 - f. Garantojnë se të gjitha kontratat dhe vendimet e institucioneve të përshkruara në pikën hyrëse, sa më sipër të kësaj kontrate, janë në fuqi të plotë, të parevokuara apo të pazgjdhura nga ana e palës shitëse apo institucioneve shtetërore, në të kundërt, mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.
- 4.2 Blerësi, nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash me kusht, garanton si më poshtë:
- a. Merr përsipër të kryejë pagesën siç përcaktohet në nenin 3 të kontratës, sipas afatit të përcaktuar më sipër;
 - b. Do të veprojë me mirëbesim dhe në konfidencialitet të plotë për të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që i është vënë në dispozicion;
 - c. Me blerjen e kuotave të shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" sh.p.k., Blerësi merr përsipër edhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj shoqërie ndaj palëve të treta, sic pasqyrohen edhe në Pasqyrat Financiare për vitin 2021 të publikuara pranë QKB përveç detyrimeve tatimore të mbartura të cilat, në momentin e shitjes së kuotave të kapitalit, duhet të jenë të shlyera.

NENI 5
Efektet e kontratës



- 5.1 Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dy palëshe.
- 5.2 Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 6
Informacioni konfidencial

- 6.1 Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe çdo informacion të krijuar me këtë kontratë.

Four handwritten signatures in blue ink are present at the bottom of the page, corresponding to the parties involved in the contract.



NENI 7
Transferimi i të drejtave

7.1 Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, kryerjes së pagesës totale nga blerësi siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj kontrate, dhe pas plotësimit të kushteve nga ana e shitësve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësi pranë regjistrit tregtar të QKB-së dhe kapitali i shoqërisë do të zotërohet tërësisht nga ortaku i ri/ blerësi, si më poshtë:

- **Shoqëria “AG Hpower & Construction” Sh.p.k. zotëruese e 1 (një) kuote kapitali, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë “HP VENDRESH ENERGY” Sh.p.k.;**

7.2 Me transferimin e kuotave, shoqërisë “AG Hpower & Construction” Sh.p.k. i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes nr. 1296 Rep., nr. 235 Kol., datë 25.03.2013, në cilësinë e Koncesionarit, Kontratës së Formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “VENDRESH” në pellgun Ujëmbledhës përroi Vendreshës, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar, Nr. 10325 Rep., nr. 3319 Kol., datë 06.09.2013 – noter Julian Zhelegu, Tiranë, të ndryshuar me Kontratë Shtesë Koncesioni për Disa Ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin e Hidrocentralit “Vendresh”, nr. 663 Rep., nr. 228 Kol., datë 18.05.2016 – notere Elona G. Qoku.

NENI 8
Kushtet

8.1 Në përputhje me nenin 84 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, palët vënë si kusht që, nëse pala blerëse nuk i paguan palës shitëse çmimin total sa më sipër, kjo kontratë do të ngelet pa fuqi ligjore dhe palët kthehen në gjendjen e mëparshme, pa detyrime financiare ndaj njëra tjetres.

8.2 Në përputhje me nenin 84 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, palët vënë si kusht që, nëse pala blerëse i paguan palës shitëse korrekt çmimin e shitjes brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, por ndërkohë pala shitëse duhet të sigurojë dokumentacionin e mëposhtëm referuar Neni 3, pika 3.2:


- Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, i cili miraton unanimitisht shitjen e Kuotave të kapitalit të shoqërisë në favor të Blerësit;
- Vërtetim tatimor që nuk ka detyrime aktuale të pashlyera ndaj organeve tatimore.
- Miratimin me shkrim nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për Blerjen, nëpërmjet transferimit të Kuotës, sipas kësaj kontrate;

8.3 Nëse pala shitëse nuk përmbush kushtet sa më sipër, atëherë kjo Kontratë Shitje Kuotash me Kusht do të ngelet pa fuqi ligjore dhe palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme:

- a. Pala Shitëse detyrohet t'i kthejë palës Blerëse menjëherë pagesat e kryera sipas Nenit 3, pika 3.2;
- b. Pala shitëse mbetet pronare e kuotave sa me sipër;

NENI 9

Ligji i aplikueshëm dhe gjykata kompetente





- 9.1 Kontrata është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.
- 9.2 Blerësi dhe shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta.
- 9.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10 Anekset e kontratës

10.1 Kësaj kontrate i bashkëngjiten si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksa të Kontratës:

1. Kontratë e Formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “VENDRESH” në pellgun Ujëmbledhës përroi Vendreshës, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar, Nr. 10325 Rep., nr. 3319 Kol., datë 06.09.2013 – noter Julian Zhelegu, Tiranë.
2. Kontratë Shtesë Koncesioni për Disa Ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim), për ndërtimin e Hidrocentralit “Vendresh” Nr. 663 Rep., Nr. 228 Kol., datë 18.05.2016 – notere Elona G. Qoku, Tiranë;
3. Leje mjedisi Nr. PN-9504-03-2015, datë 10.03.2015, lëshuar nga QKL.
4. Leje për përdorimin e burimit ujor, Nr. serie 00028, Nr. 544/1 Prot., datë 01.11.2016, nga Këshilli Kombëtar i Ujit.
5. Miratim pik lidhje HEC Vendresha, Nr. 607/3 Prot., datë 17.01.2019, nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
6. Pronësia mbi të cilën do të ndërtohet objekti vërtetohet me:
 1. Çertifikatë për vërtetim pronësie, pasuri e regjistruar në ZVRPP Skrapar me:
 - Nr. **pasurie 425**, vol 6, faqe 152, zona kadastrale 3596, me sipërfaqe **625 000 m2** e llojit **Pyll**, me adresë Skrapar, Therepel;
 - Nr. **pasurie 426**, vol 6, faqe 153, zona kadastrale 3596, me sipërfaqe **215 000 m2** e llojit **Pyll**, me adresë Skrapar, Therepel.
 - Nr. **pasurie 427**, vol 6, faqe 154, zona kadastrale 3596, me sipërfaqe **247 500 m2** e llojit **Pyll**, me adresë Skrapar, Therepel;
 - Nr. **pasurie 428**, vol 6, faqe 154, zona kadastrale 3596, me sipërfaqe **175 000 m2** e llojit **Pyll**, me adresë Skrapar, Therepel;

Pronësi e vërtetuar nga Çertifikata për vërtetim pronësie në emër e për llogari të Qarkut Berat, Komuna Vendreshë, me Nr. 336, datë 29.06.2015; kartela dhe harta e saj treguese.

7. Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë: “HP VENDRESH ENERGY” Sh.p.k. Nr. 2 datë 10.10.2022 si dhe Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë: “AG Hpower & Construction” Sh.p.k., Nr.28 date 10.10.2022.

177

8. Ekstraktet e Regjistrit Tregtar për secilën palë;
9. Vërtetim tatimor që Shoqëria "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k. nuk ka detyrime tatimore të pashlyera;
10. Dokument verifikues për përcaktimin e sekuestrove të shoqërive "JDS" sh.p.k. dhe "2RC" sh.p.k..

Neni 11 Dispozita përfundimtare

- 11.1 Kjo kontratë është hartuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë ligjore, nga një për secilën palë, e cila u lexua me zë të lartë e të qartë nga palët.
- 11.2 Palet deklaruan se e dëgjuan, e kuptuan dhe meqenëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje.
- 11.3 Gjithashtu, palët më autorizojnë mua, noterin, për përdorimin e të dhënave personale të tyre, të bëra të ditura sa më sipër, dhe se të dhënat e përdorura nga unë, noteri, në këtë dokument, do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 – i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSIT

1-Shoqëria "2RC" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

Z. Bardhyl Hysenbelliu
Z. Bardhyl Hysenbelliu
Administrator



BLERËSI

"AG Hpower & Construction" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

Z. Zeni Tërpolli
Z. Zeni Tërpolli
Administrator



2-Shoqëria "JDS" sh.p.k.

Përfaqësuar nga:

Z. Misir Dyrmishi
Administrator

Z. Misir Dyrmishi
Z. Misir Dyrmishi
Administrator
JDS SHPK
NIPT L38912401L

"HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z. Joni Dyrmishi
Z. Joni DYRMISHI
Administrator
HP VENDRESH ENERGY
NIPT L396045025
TAPAR - ALBANIA

NOTERI

Ermal Xh. HAMZAJ



Handwritten scribbles and faint lines on the left side of the page.



Faint handwritten text at the bottom center of the page.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426

KONTRATA TË TJERA

(SHITESË KONTRATE)

Nr. repertori: 7662

Nr. koleksioni: 4798

Tirane më 30/12/2022

Ligjet referuese:

- 1 Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2 Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3 Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterine", i ndryshuar



A2022053150519936765



REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NOTER ERMAL HAMZAJ

Nr. 7662 Rep.

Nr. 6796 Kol.



AMENDIM NR. 1
I KONTRATËS SË SHITJES ME KUSHT TË KUOTAVE TË SHOQËRISË
NR. REPERTORI 5884, NR. KOLEKSIONI 3646, DT. 11/10/2022

Në Tiranë, sot në datën 30/12/2022 (dymijë e njëzet e dy), përpara meje noterit Ermal Xh. Hamzaj, Anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me liçence profesionale nr.511, në zyrën time noteriale me adresë Rr. "Pashko Vasa", u paraqitën personalisht palet:

Shitësi:

1- Shoqëria "2RC" Sh.p.k. (ish 2R-Construction Sh.p.k.), shoqëri tregtare e regjistruar pranë QKB më datë 03.11.2008, e identifikuar me NUIS: K82303007K, me seli në: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga "Pashko Vasa", Pallati Nr. 8, Tiranë; përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm, Z. Bardhyl Hysenbelliu, atësia Hasan, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 27.05.1967, lindur në Potom dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin ID me Nr. 033761089 dhe nr. Personal G70527056Q.

Dhe

2- Shoqëria "JDS" Sh.p.k., shoqëri tregtare e regjistruar pranë QKB më datë 12.03.2013, e identifikuar me NUIS: L38912401L, përfaqësuar nga administrator dhe ortaku i vetëm Z. Misir Dymishi, atësia Jaçe, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i datëlindjes 27.10.1964, lindur në Çorovodë, identifikuar me letërnjoftimin ID me Nr. 033347738 dhe nr. Personal G41027042H, te dy këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Shitësit**

Dhe

Blerësi

Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k., shoqëri tregtare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mbajtëse e NUIS L91924026B, me seli në Fier, Lagjia Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier - Tiranë, pranë Urës së Mbrostarit, e përfaqësuar nga Administratori i Shoqërisë Z. Zeni Tërpollari, lindur më datë 13.08.1984 në Çorovodë, Skrapar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 035364689 dhe numër personal I40813012F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për te vepruar, këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Blerësi**,

Dhe

Miratuesi

Shoqëria **"HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k.,** shoqëri tregtare, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, më 04.10.2013, me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L39604402S, me adresë: Berat,

11/11/11

Çorovodë, Komuna Qëndër, Buzuq, përfaqësuar nga Administratori, Z. Joni Dyrmishi, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, atësia Misir, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar, më 26.05.1994 dhe banues në Skrapar, me adresë: E Kanioneve, Nd. 17; H.1; Çorovodë; 5401, Skrapar; për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 036386211 dhe nr. personal J40526003V,
Këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Miratuesi dhe Huamarrësi**,

Hyrje

Meqenese ekzistojnë kushtet paraprake:

- Shoqëria "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., në cilësinë e Huamarrësit, ka lidhur një Kontratë Huaje, Nr.1224 Rep, Nr.386 Kol, Dt. 17.02.2015, Amendimin e Kontratës së Huasë, nr. Rep.8924, nr. Kol. 2742, dt. 16.12.2019 dhe Amendimin Nr.2 të Kontratës së Huasë, nr. Rep.19, nr. Kol. 11, dt. 05.01.2021, me Huadhënësin Z. Bardhyl Hysenbelliu dhe,

- Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k. është njoftuar me Njoftimin e datës 08/08/2022 lidhur me Huanë e dhënë nga Huadhënësi Z. Bardhyl Hysenbelliu ndaj shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., detyrimi i cili në momentin e shitjes vlerësohet në masën 350.000 EUR (treqind e pesëdhjetë mijë euro).

Pasi verifikova statusin juridik të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, une Noteri, konstatova se palët e mësipërme janë të gjithë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë me kërkuan hartimin e këtij amendimi në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Kodin Civil të RSH.

Palët këtu bien dakord për amendimet e mëposhtme, si vijon:

1. Referuar Nenit 4.2 shtohet pika "d", "e" dhe "f" ku përcaktohet se:

- d. Blerësi, Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k., e njej dhe miraton detyrimin e huasë për të cilin ka marrë dijëni, si dhe garanton se pas kalimit të kuotave të kapitalit, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë huamarrëse, do të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme që shoqëria "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k. të shlyejë detyrimin e huasë ndaj Huadhënësit, Z. Bardhyl Hysenbelliu në vlerën totale prej 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) Euro (përfshirë interesat e huasë), brenda 10 ditëve nga data e aprovimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për Shit-Blerjen, nëpërmjet transferimit të Kuotave të kapitalit.
- e. Blerësi, Shoqëria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k. gjithashtu merr përsipër rolin e Dorëzanësit për shlyerjen e plotë të detyrimit të huasë sic përcaktohet më sipër, në rast se shoqëria Huamarrëse "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k. nuk arrin ta shlyejë këtë detyrim.
- f. Shlyerja e detyrimeve të huasë, sa përcaktuar më sipër, do të kryhet bazuar në Kontratën e Huasë së sipërpërmendur dhe Amendimeve përkatëse të nënshkuara nga palët.



100

1

2. Referuar nenit 4, shtohet pika 4.3, me nënpikat e mëposhtme:

- a. Detyrimet që mund të lindin si rrjedhojë e dokumentit zyrtar nr. Prot. 1172/5, datë 26/09/2022, dërguar nga AKBN, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për dijeni shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k., mbeten totalisht përgjegjësi e shoqërisë "JDS" Sh.p.k., përfaqësuar nga administratori dhe ortak i vetëm Z. Misir Dymishi.
- b. Palët bien dakord që shoqëria 2RC sh.p.k. dhe Z. Bardhyl Hysenbelliu (në cilësinë e ortakut të vetëm/administrator të shoqërisë 2RC sh.p.k. dhe ish-ortakut të shoqërisë "JDS" sh.p.k.), çlirohen nga të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare për çështje të lindura para dhe pas shitjes së kuotave të kapitalit të shoqërisë "HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k..

Përveç sa parashikuar më sipër, të gjitha kushtet e tjera të Kontratës së Shitjes me Kusht të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë Nr. Repertori 5884, Nr. Koleksioni 3646, Dt. 11/10/2022 do të mbeten të pandryshuara.

Ky Amendim hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.


Ky amendim i kontratës hartohet në 5 (pesë) kopje me vlerë të njëjtë ligjore dhe palët e nënshkruajnë rregullisht sipas ligjit.

PALET

SHITESIT

Shoqëria "2RC" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:


Z. Bardhyl Hysenbelliu
Administrator/Ortak i Vetëm

Shoqëria "JDS" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:


Z. Misir Dymishi
Administrator/Ortak i Vetëm


JDS SHPK

NIPT L38912401L

BLERËSI

"AG Hpower&Construction" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:


Z. Zeni Tërpollari
Administrator




MIRATUESI:

"HP VENDRESH ENERGY" Sh.p.k.

Përfaqësuar nga:


Z. Joni DYMISHI
Administrator



NOTERI


NOTER
GJYKESI I D. PANZA

Handwritten blue ink mark, possibly a signature or initials, located in the upper right quadrant of the page.

Handwritten blue ink mark, possibly a signature or initials, located in the lower left quadrant of the page.

Faint, circular handwritten blue ink mark, possibly a stamp or seal, located in the lower left quadrant of the page.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NIKOLETA P. GJORDENI
ADRESA MYSLYM SHYRI, NR.30
TEL: 696051791

KONTRATA TË TJERA

(NDRYSHIM KONTRATA TE TJERA)

Nr. repertori: 3978

Nr. koleksioni: 1435

Tirane më 23/10/2023


Ligjet referuese:

- 1 Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2 Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3 Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2023053100167099754

*Akti notarial përbëhet nga 4 fletë





AMENDIM NR. 2

I KONTRATËS SE SHITJES ME KUSHT I KUOTAVE TE SHOQERISE NR. REP. 5884, NR. KOL. 3646, DATE 11/10/2022, NDRYSHUAR ME AKTIN

KONTRATA TE TJERA (SHTESE KONTRATE), ME NR. 7662 REP, NR. 4798 KOL, DATE 30.12.2022

Sot, me datë 23.10.2023 (dy mije e njetzet e tre), para meje noteres **NIKOLETA P. GJORDENI**, Anetare e Deges Vendore te Notereve - Tirane, me seli ne Rruga "Myslym Shyri", pall. 30, kati 2, u paraqiten personalisht,

PALA E PARE

SHOQËRIA "2RC" SHPK, person juridik shqiptar, me **NIPT. K82303007K**, regjistruar në QKB, me datë 03/11/2008, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, në Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr.8, përfaqësuar nga ortaku i vetëm/njekohesisht administrator, **z. Bardhyl Hysenbelliu**, atësia Hasan, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Potom, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Vaso Pasha; Nd. 1826; H. 1; Ap. 012; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 27/05/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033761089 dhe nr. personal G70527056Q, ortake- zotëruese e kuotës që përbën 5% (pese) të kapitalit të shoqërisë Konkensionare "Hp Vendresh Energy" Shpk, **ne cilesine e SHITESIT**, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";

SHOQËRIA "JDS" SHPK, person juridik shqiptar, me **NIPT. L38912401L**, regjistruar në QKB, me datë 12/03/2013, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, Berat, Corovode, Skrapar, lagja "Çlirimi", banese private, perballe Tregut, **përfaqësuar nga ortaku i vetëm/ njekohesisht administrator, z. Misir Dyrmishi**, atësia Jaçe, amësia Zegjine, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në SKRAPAR, me adresë E Kanioneve 00210012; Nd. 17; H. 1; Çorovodë; Çorovodë; 5401; Skrapar, lindur më 27/10/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033347738 dhe nr. personal G41027042H, ortake- zotëruese e kuotës që përbën 95% (nentedhjetë e pese) të kapitalit të shoqërisë Konkensionare "Hp Vendresh Energy" shpk, **ne cilesine e SHITESIT**, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";

PALA E DYTE

SHOQËRIA "AG HPOWER & CONSTRUCTION" SHPK, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit **NIPT L91924026B**, me seli ne "Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier", **PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI NEKIDA BAHA**, atësia Ardjan, amësia Ruzhdije, shtetase Shqiptare, lindur në Xibrakë, Elbasan dhe banuese në Tiranë, me adresë Lord Bajron; Nd. 041; H. 1; Njësia Administrative Nr. 11; Njesia Bashkiake Nr. 11; 1031; Tiranë, lindur më 25/08/1995, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033292573 dhe nr. personal J55825018O., **ne cilesine e BLERESIT** ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";

PALA E TRETE

SHOQËRIA "HP VENDRESH ENERGY" SHPK, person juridik shqiptar, shoqeri konkensionare, e regjistruar ne QKB, me date 04.10.2013, e identifikura me **NIPT. L39604402S**, me seli te ushtrimit te aktivitetit ne "Komuna Qëndër, Buzuq, Çorovode, Berat, **PERFAQESUAR NGA ADMINISTRATORI Z. JONI DYRMISHI**, atësia



A2023053100167099754

Misir, amësia Laureta, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Shyqyri Bërxolli; Nd. 55; H. 3; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 26/05/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036386211 dhe nr. personal J40526003V, ne cilesine e MIRATUESIT, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Paluajtshme (nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Hamzaj- Tirane";

KUSHTET PARAPRAKE

Palet kontraktuale ne cilesite perkatese, kane nenshkruar "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Hamzaj- Tirane" dhe "Kontrata te Tjera (Shtese Kontrate), me nr. 7662 Rep, nr. 4798 Kol, date 30.12.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj- Tirane";

Ne marreveshje te plote me njerin-tjetrin dhe ne permbushje te parashikimeve kontraktuale perkatese dhe interesave te tyre, palet kane vendosur ndryshimin e percaktimeve kontraktuale, si vijon:

Neni 1

Pika 3.2 e Nenit 3 (Cmimi dhe Menyra e Pageses), ISHTE:

- "Cmimi i Shitjes ne total ne vleren prej EUR 150, 000 (njeqind e pesedhjete mije euro), do te depozitohet nga bleresi ne llogarine bankare te shitesve, perkatesisht sa me siper, brenda nje afati prej 10 (dhjete) ditesh, duke filluar nga data e aprovimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastruktures dhe Energjise), per Shit-Blerjen nepermjet transferimit te Kuotave te Kapitalit".

Pika 3.2 e Nenit 3 (Cmimi dhe Menyra e Pageses), BEHET:

- "Cmimi i Shitjes ne total ne vleren prej EUR 150, 000 (njeqind e pesedhjete mije euro), do te depozitohet nga bleresi ne llogarine bankare te shitesve, perkatesisht sa me siper, brenda nje afati prej 10 (dhjete) ditesh, nga nenshkrimi Amendim nr. 2 i Kontrates se Shitjes se Kuotave.

Neni 2

Pika d), e Nenit 4.2 te Kontrates, referuar Amendim Kontrates, ISHTE:

d) Bleresi, Shoqeria "Ag Hpower & Construction" Shpk, e njej dhe miraton detyrimin e huase per te cilin ka marre dijeni, si dhe garanton se pas kalimit te kuotave te kapitalit, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise huamarrese, do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme qe shoqeria "Hp Vendresh Energy" shpk, te shlyeje detyrimin e huase ndaj Huadhenesit, z. Bardhyl Hysenbelliu ne vleren totale prek 350, 000 euro (treqind e pesedhjete mije) (perfshire interesat e huase), brenda 10 diteve nga data e aprovimit nga Autoriteti Kontraktues (Ministria e Infrastruktures dhe Energjise), per Shit-Blerjen, nepermjet Transferimit te Kuotave te Kapitalit.

Pika d), e Nenit 4.2 te Kontrates, referuar Amendim Kontrates, BEHET:

d) Bleresi, Shoqeria "Ag Hpower & Construction" Shpk, e njej dhe miraton detyrimin e huase per te cilin ka marre dijeni, si dhe garanton se pas kalimit te kuotave te kapitalit, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise huamarrese, do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme qe shoqeria "Hp Vendresh Energy" shpk, te shlyeje detyrimin e huase ndaj Huadhenesit, z. Bardhyl Hysenbelliu ne vleren totale prek 350, 000 euro (treqind e pesedhjete mije) (perfshire interesat e huase), brenda 10 diteve nga nenshkrimi i Amendim, nr. 2.



A2023053100167099754

Përcaktohet dhe përcaktohet me siper, te gjitha kushtet e tjera te Kontrates se Shitjes me Kusht te Kuotave te Kapitalit te Shoqerise, nr. Repertori 5884, nr. Koleksioni 3646, date 11.10.2022 dhe "Kontrata te Tjera (Shtese Kontrate), me nr. 7662 Rep, nr. 4798 Kol, date 30.12.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj- Tirane", do te mbeten te pandryshuara.

Palet e kontrates deklarim se ndryshimet e mesiperme kane hyre ne fuqi midis tyre qe ne momentin e nenshkrimt te kesaj kontrate. **KJO ANEKS KONTRATË I BASHKENGJITET TE KONTRATES SE SHITJES ME KUSHT TE KUOTAVE TE KAPITALIT TE SHOQERISE, NR. REPERTORI 5884, NR. KOLEKSIONI 3646, DATE 11.10.2022 DHE "KONTRATA TE TJERA (SHTESE KONTRATE), ME NR. 7662 REP, NR. 4798 KOL, DATE 30.12.2022, NOTER ERMAL XH. HAMZAJ- TIRANE" DHE ESHTË PJESE E PANDARE E SAJ DUKE U LEXUAR DHE INTERPRETUAR SI NJE E TERE.**

Palet moren dijeni se te dhenat e tyre personale, une noteria do ti perdor ne zbatim te ligjit vetem per efekt te redaktimit te ketij akti. Perpunimi i ketyre te dhenave do te behet prej meje vetem ne respektim te plote dhe zbatimin rigoroz te dispozitave te ligjit 9887, date 10.03.2008, i ndryshuar "Per mbrojtjen e te dhenave personale,,Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITESI

SHOQËRIA "2RC" SHPK

Perfaqesuar nga Bardhyl Hysenbelliu

Bardhyl Hysenbelliu



SHOQËRIA "JDS" SHPK

Perfaqesuar nga Misir Dyrmishi

Misir Dyrmishi



BLERESI

SHOQËRIA "AG HPOWER & CONSTRUCTION" SHPK

Perfaqesuar nga Nekida Baha



MIRATUESI

SHOQËRIA "HP VENDRESH ENERGY" SHPK

Perfaqesuar nga Joni Dyrmishi

Joni Dyrmishi



(Signature)
NOTERE
NIKOLETA P. GJORDENI



IBO
IBO
IBO



Sp.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NIKOLETA P. GJORDENI
ADRESA MYSLYM SHYRI, NR.30
TEL: 696051791

KONTRATA TË TJERA

(SHTESË KONTRATE)

Nr. repertori: 4179

Nr. koleksioni: 1496

Tirane më 07/11/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

* Akti notarial përbëhet nga 3 blutë



A2023053100173255857

IKAE PRODUCTIONS
A. F. 6000 5111



A2023053100173255857



AMENDIM NR. 3
I KONTRATES SE SHITJES ME KUSHT I KUOTAVE TE SHOQERISE NR. REP. 5884, NR. KOL. 3646, DATE
11/10/2022,

NDRYSHUAR ME AKTIN

"KONTRATA TE TJERA (SHTESE KONTRATE), ME NR. 7662 REP, NR. 4798 KOL, DATE 30.12.2022;
NDRYSHUAR ME AKTIN

"KONTRATA TE TJERA (NDRYSHIM KONTRATA TE TJERA), ME NR. 3978 Rep, nr. 1435 KOL, DATE
23.10.2023".

Sot, me datë 07.11 2023 (dy mijë e njezet e tre), para meje noteres **NIKOLETA P. GJORDENI**, Anetare e Deges Vendore te Notereve - Tirane, me seli ne Rruga "Myslym Shyri", pall. 30, kati 2, u paraqiten personalisht,

PALA E PARE

SHOQËRIA "2RC" SHPK, person juridik shqiptar, me **NIPT. K82303007K**, regjistruar në QKB, me datë 03/11/2008, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, në Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr.8, përfaqësuar nga ortakut i vetëm/njekohesisht administrator, **z. Bardhyl Hysenbelliu**, atësia Hasan, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Potom, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Vaso Pasha; Nd. 1826; H. 1; Ap. 012; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 27/05/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033761089 dhe nr. personal G70527056Q, ortake- zotëruese e kuotës që përbën 5% (pese) të kapitalit të shoqërisë Konkensionare "Hp Vendresh Energy" Shpk, **ne cilesine e SHITESIT**, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";


SHOQËRIA "JDS" SHPK, person juridik shqiptar, me **NIPT. L38912401L**, regjistruar në QKB, me datë 12/03/2013, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, Berat, Corovode, Skrapar, lagja "Çlirimi", banese private, perballe Tregut, **përfaqësuar nga ortakut i vetëm/ njekohesisht administrator, z. Misir Dyrmishi**, atësia Jaçe, amësia Zegjine, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në SKRAPAR, me adresë E Kanioneve 00210012; Nd. 17; H. 1; Çorovodë; Çorovodë; 5401; Skrapar, lindur më 27/10/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033347738 dhe nr. personal G41027042H, ortake- zotëruese e kuotës që përbën 95% (nentedhete e pese) të kapitalit të shoqërisë Konkensionare "Hp Vendresh Energy" shpk, **ne cilesine e SHITESIT**, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";

PALA E DYTE

SHOQËRIA "AG HPOWER & CONSTRUCTION" SHPK, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit **NIPT L91924026B**, me seli ne "Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier", **PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI NEKIDA BAHA**, atësia Ardjan, amësia Ruzhdije, shtetase Shqiptare, lindur në Xibrakë, Elbasan dhe banuese në Tiranë, me adresë Lord Bajron; Nd. 041; H. 1; Njësia Administrative Nr. 11; Njesia Bashkiake Nr. 11; 1031; Tiranë, lindur më 25/08/1995, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033292573 dhe nr. personal J558250180., **ne cilesine e BLERESIT** ne "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali), me nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj";

PALA E TRETE

SHOQERIA "HP VENDRESH ENERGY" SHPK, person juridik shqiptar, shoqeri konkensionare, e regjistruar ne QKB, me date 04.10.2013, e identifikura me **NIPT. L39604402S**, me seli te ushtrimit te aktivitetit ne



1950
1951
1952
1953
1954
1955
1956
1957
1958
1959
1960



A2023053100173255857

"Komuna Qëndër, Buzuq, Çorovode, Berat, **PERFAQESUAR NGA ADMINISTRATORI Z. JONI DYRMISHI**, atësia Misir, amësia Laureta, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Shyqyri Bërçolli, Nd. 55; H. 3; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 26/05/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036386211 dhe nr. personal J40526003V, ne cilesine e MIRATUESËT, ne "Kontrate Shitje Pasuri e Paluajtshme (nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Hamzaj- Tirane";

KUSHTET PARAPRAKE

Palet kontraktuale ne cilesite perkatese, kane nenshkruar "Kontrate Shitje Pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) nr. 5884 Rep, nr. 3646 Kol, date 11.10.2022, noter Ermal Hamzaj- Tirane" dhe "Kontrata te Tjera (Shtese Kontrate), me nr. 7662 Rep, nr. 4798 Kol, date 30.12.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj- Tirane", Amendim, nr. 2, "Kontrata te Tjera (Ndryshim Kontrata Te Tjera), me nr. 3978 rep, nr. 1435 kol, date 23.10.2023, notere Nikoleta Gjordeni";

Ne marreveshje te plote me njerin-tjetrin dhe ne permbushje te parashikimeve kontraktuale perkatese dhe interesave te tyre, palet kane vendosur ndryshimin e percaktimeve kontraktuale, sa i takon afatit, si vijon:

Neni 1

Pika 3.2 e Nenit 3 (Cmimi dhe Menyra e Pageses), sipas Amendim, nr. 2 (NENI 1), ISHTE:

- "Cmimi i Shitjes ne total ne vleren prej EUR 150, 000 (njqind e pesedhete mije euro), do te depozitohet nga bleresi ne llogarine bankare te shitesve, perkatesisht sa me siper, brenda nje afati prej 10 (dhjete) ditesh, nga nenshkrimi Amendim nr. 2 i Kontrates se Shitjes se Kuotave.

Pika 3.2 e Nenit 3 (Cmimi dhe Menyra e Pageses), BEHET:

- "Cmimi i Shitjes ne total ne vleren prej EUR 150, 000 (njqind e pesedhete mije euro), do te depozitohet nga bleresi ne llogarine bankare te shitesve, perkatesisht sa me siper, brenda nje afati prej 10 (dhjete) ditesh, nga nenshkrimi Amendim nr. 3 i Kontrates se Shitjes se Kuotave.

Neni 2

Pika d), e Nenit 4.2 te Kontrates, referuar Amendim Kontrates (nr. 1) dhe Amendim, nr. 2 (NENI 2), ISHTE:

d) Bleresi, Shoqeria "Ag Hpower & Construction" Shpk, e njeh dhe miraton detyrimin e huase per te cilin ka marre dijeni, si dhe garanton se pas kalimit te kuotave te kapitalit, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise huamarrese, do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme qe shoqeria "Hp Vendresh Energy" shpk, te shlyeje detyrimin e huase ndaj Huadhenesit, z. Bardhyl Hysenbelliu ne vleren totale prek 350, 000 euro (treqind e pesedhete mije) (perfshire interest e huase), brenda 10 diteve nga nenshkrimi i Amendim, nr. 2.

Pika d), e Nenit 4.2 te Kontrates, referuar Amendim Kontrates (nr. 1), BEHET:

d) Bleresi, Shoqeria "Ag Hpower & Construction" Shpk, e njeh dhe miraton detyrimin e huase per te cilin ka marre dijeni, si dhe garanton se pas kalimit te kuotave te kapitalit, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise huamarrese, do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme qe shoqeria "Hp Vendresh Energy" shpk, te shlyeje detyrimin e huase ndaj Huadhenesit, z. Bardhyl Hysenbelliu ne vleren totale prek 350, 000





A2023053100173255857

euro (treqind e pesedhjetë mijë) (përfshirë interesat e huase), brenda 10 diteve nga nënshkrimi i Amendim, nr. 3.

Përveç sa parashikuar më sipër, të gjitha kushtet e tjera të Kontrates së Shitjes me Kusht të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë, nr. Repertori 5884, nr. Koleksioni 3646, datë 11.10.2022 dhe "Kontrata e Tjera (Shtese Kontrate), me nr. 7662 Rep, nr. 4798 Kol, datë 30.12.2022, noter Ermal Xh. Hamzaj- Tirane" dhe Amendim, nr. 2- KONTRATA E TJERA (NDRYSHIM KONTRATA E TJERA), ME NR. 3978 Rep, nr. 1435 KOL, DATE 23.10.2023- notere N. Gjorderni", do të mbeten të pandryshuara.

Palet e kontrates deklarojnë se ndryshimet e mësipërme hyjnë në fuqi, në momentin e nënshkrimit të Amendim, nr.3.

AMENDIM, NR. 3, I BASHKENGJITET TË "KONTRATES SË SHITJES ME KUSHT TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË, NR. REPERTORI 5884, NR. KOLEKSIONI 3646, DATE 11.10.2022" DHE "KONTRATA E TJERA (SHTESE KONTRATE), ME NR. 7662 REP, NR. 4798 KOL, DATE 30.12.2022, NOTER ERMAL XH. HAMZAJ- TIRANE" DHE "AMENDIM, NR. 2- KONTRATA E TJERA (NDRYSHIM KONTRATA E TJERA), ME NR. 3978 REP, NR. 1435 KOL, DATE 23.10.2023- NOTERE N. GJORDERNI", ESHTË PJESË E PANDARË E SAJ DUKE U LEXUAR DHE INTERPRETUAR SI NJË E TERË.

Palet më nën dëgjimi se të dhënat e tyre personale, unë noteria do të përdor në zbatim të ligjit vetëm për efekt të redaktimit të këtij akti. Përpunimi i këtyre të dhënave do të bëhet prej meje vetëm në respektim të plotë dhe zbatimin rigoroz të dispozitave të ligjit 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale,,

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITESI

SHOQËRIA "ZRC" SHPK

Perfaqësuar nga Bardhyl Hysenbelliu

Bardhyl Hysenbelliu



SHOQËRIA "JDS" SHPK

Perfaqësuar nga Misir Dyrmishi

Misir Dyrmishi

BLERESI

SHOQËRIA "AG HPOWER & CONSTRUCTION" SHPK

Perfaqësuar nga Nekida Baha

Nekida Baha



MIRATUESI

SHOQËRIA "HP VENDRESH ENERGY" SHPK

Perfaqësuar nga Joni Dyrmishi

Joni Dyrmishi



NOTERE
NIKOLETA P. GJORDERNI

Nikoleta P. Gjorderni



